



RAPORTI I EKIPIT TË AUDITIMIT SOCIAL NË LIPJAN

PROJEKTET E MONITORUARA

“Ndërtimi i sallës së sportive në shkollën Ismail Luma”

“Ndërtimi i çerdhës në Rufc të Ri – faza e dytë”





Ky raport është përgatitur nga projekti DEMOS, zbatuar nga Helvetas Swiss Intercooperation Kosovo. Mohim: Gjetjet dhe konkluzionet e shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian, Zvicrës dhe Suedisë.

RAPORTI I EKIPIT TË AUDITIMIT SOCIAL NË LIPJAN

PROJEKTET E MONITORUARA
“Ndërtimi i sallës së sporteve në shkollën Ismail Luma”
“Ndërtimi i çerdhes në Rufc të Ri – faza e dytë”

Dhjetor 2024



DEMOS Decentralisation and Municipal Support

Projekti për Decentralizimin dhe Përkrahjen e Komunave (DEMOS) mbështet 38 komuna të Republikës së Kosovës në arritjen e qeverisjes lokale më demokratike dhe menaxhimit më të mirë komunal. Projekti DEMOS gjithashtu mbështet Qeverinë e Kosovës në zhvillimin e politikave, të cilat janë më të favorshme për financim të bazuar në rregulla për komunat.

Projekti bashkëfinanohet nga Bashkimi Evropian në Kosovë, Qeveria Zvicerane dhe Qeveria Suedeze dhe zbatohet nga Helvetas Swiss Intercooperation Kosovë.

Mbështetja e DEMOS për komunat e Kosovës është në kuadër të Grantit të Performancës Komunale si njëri nga mjetet që garanton përkrahje për komunat me performancë të mirë.

Fokus i veçantë i projektit është edhe përkrahja për qeverinë qendrore ku DEMOS është i fokusuar në ofrimin e asistencës në ndërtimin e politikave për një kornizë më të favorshme për qeverisje të decentralizuar.

Sipas komponentës së parë të projektit, DEMOS III synon të hapë të dhënat për një shqyrtim më të gjerë publik mbi performancën komunale dhe të iniciojë auditime sociale për të monitoruar ndikimin e projekteve të Grantit të Performancës Komunale (GPK) tek qytetarët.

Projekti i DEMOS ka mbështetur edhe ndërtimin dhe zhvillimin e aktiviteteve që përfshijnë qytetarët në vendimarrje përfshirë ekipet e Auditimit Social të cilat kanë mbikëqyrur implementimin e projekteve të cilat janë financuar nga Granti i Performancës.



BIRN Kosova është një organizatë e pavarur, joqeveritare, qëllimet e së cilës janë informimi i qytetarëve dhe kontributi në procesin e tranzicionit demokratik në vend, promovimi i llogaridhënies, sundimi i ligjit dhe reforma e politikave. BIRN Kosova në veçanti synon të shërbejë si mbikëqyrës i institucioneve publike, duke monitoruar punën e institucioneve qeverisëse dhe publike. Përveç kësaj, përmes prodhimit të debateve televizive cilësore dhe të paanshme dhe trajnimit të të rinjve mbi aftësitë argumentuese dhe debatuese, BIRN synon të promovojë dhe inkurajojë një kulturë të debatit në Kosovë.

Vizioni i BIRN është të sigurojë pozicionin e saj si organizata kryesore e gazetarisë hulumtuese në Kosovë, duke adresuar nevojën për raportim objektiv, cilësor dhe të qëndrueshëm mbi sfidat e shumta të vendit. BIRN Kosova në partneritet me Demokraci Plus është angazhuar nga DEMOS për të bërë lehtësimin/fasilitimin e Auditimit Social në 11 projektet e përgjedhura në gjashtë komuna, Gjakovë, Pejë, Klinë, Malishevë, Lipjan dhe Obiliq.



Demokraci Plus (D+) është organizatë e pavarur dhe jofitimprurëse e themeluar në mars të vitit 2016. D+ është e përkushtuar për krijimin e një shoqërie demokratike përmes rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në procese politike, rritjes së llogaridhënies dhe ndikimit në proceset e vendimmarrjes. D+ tenton integrimin e teknologjisë informative në të gjitha përpjekjet e tyre, kjo për të nxitur përdorimin e internetit, i cili ka rol të rëndësishëm në demokratizimin e një shoqërie. D+ synon që të kontribuojë

në krijimin e praktikave të mira për qeverisje të mirë nga institucionet publike në nivel qendror dhe lokal, fuqizimin e sundimit të ligjit, avancimin e partive politike, si dhe përkrahjen e proceseve të lira dhe të drejta zgjedhore. D+ ndërmerr iniciativa që kanë për qëllim afrimin e vendimmarrësve më afër qytetarëve përmes hulumtimeve të politikave, lehtësimit të dialogut apo komunikimit dhe edukimit publik.

PËRMBAJTJA

4	DEMOS dhe qëllimi i projektit
7	Përmbledhja ekzekutive
8	Gjetjet e përgjithshme në të dy projektet
9	Gjetjet specifike në projektin “Ndërtimi i sallës së sporteve në shkollën Ismail Luma”
9	Gjetjet specifike në projektin “Ndërtimi i çerdhes në Ruc të Ri – faza II”
10	Ambienti ku zhvillohet procesi i Auditimit Social
11	Kapitulli I - Gjetjet e përbashkëta në të dy projektet
11	Gjetjet në procesin e konsultimeve me qytetarët
12	Projektet nevojë e komunitetit
12	Mungesa e diskutimit të projektit me komunitetin
13	Mungesa e transparencës në publikimin e projekteve investive dhe dokumenteve përcjellëse
14	Kapitulli II - Gjetjet specifike në projektin “Rregullimi i sallës së sportit në shkollën Ismail Luma”
14	Vonesat dhe shkëputja e kontratës
15	Diskutimet për zgjatje të planit dinamik
15	Rreziku në ndërtimin e papërfunduar
16	Gabimet në planifikimin e projektit
16	Distanca fizike mes sallës dhe shkollës
16	Mungesa e zhveshtores
17	Mungesa e dhomës së rekuizitave
17	Mungesa e sanitarisë së veçantë
17	Problemi i kapacitetit të ngrohjes
17	Mundësia që të luhen sporte të ndryshme në sallë
17	Mosplanifikimi i qasjes për personat me aftësi të kufizuar
18	Kapitulli III - Gjetjet specifike në projektin “Ndërtimi i çerdhes në Ruc të Ri”
18	Ndryshimi i pozitës nga projekti ideor
18	Kontratat për punë shtesë
19	Mungesa e rrethojave të oborrit të çerdhes
19	Këndi i lojërave i papërshtatshëm për fëmijët e çerdhes
19	Intervenimet në hapësirat e brendshme të çerdhes
20	Përfundime / rekomandime
22	Metodologjia
23	Kush e themeloi grupin e Auditimit Social?
23	Si u grumbulluan të dhënat?
23	Validimi i të dhënave
23	Përbërja e ekipit
24	Aktivitetet e grupit të Auditimit Social
25	Ekipi i Auditimit Social në Lipjan
27	Letra e kryetarit të Komunës së Lipjanit
28	Letra e ekipit të Auditimit Social në Komunën e Lipjanit

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Një ekip i aktivistëve të shoqërisë civile, të mbështetur nga programi trajnues i projektit DEMOS nisën të pilotojnë nismën e angazhimit qytetar në mbikëqyrjen e implementimit të projekteve publike. Grupet e qytetarëve u emëruan grupe të “Auditimit Social”.

Si koncept i ri në Kosovë, Auditimi Social nisi të implementohet nga DEMOS dhe Organizata të Shoqërisë Civile në vitin 2022 për t’u vazhduar më pas në vitin 2023 dhe në vitin 2024. Me mbështetjen e DEMOS u themeluan dy grupe të Auditimit Social me rreth 300 qytetarë aktivë të përfshirë në këto procese. Anëtarët e trajnuar të ekipeve të Auditimit Social u shndërruan në aktivistë dhe dhanë mbi 100 rekomandime konkrete për qeverisjen lokale me qëllim përmirësimin e punëve komunale.

Gjatë vitit 2024, BIRN dhe D+ me mbështetjen e DEMOS ndihmuan në themelimin 11 ekipeve të Auditimit Social në gjashtë komuna, Gjakovë, Pejë, Klinë, Malishevë, Lipjan dhe Obiliq.

Programi mori mbështetjen e qeverisjes lokale. Gjashtë kryetarët e komunave nënshkruan marrëveshje mirëkuptimi me organizatat, me qëllim të lehtësimit të procesit të Auditimit

Social. Komuna e Lipjanit është në mesin e komunave përfituese nga fondet e Grantit të Performancës Komunale.

Në muajin korrik, D+ nisi hulumtimin për identifikimin e qytetarëve aktivë të kësaj komune, të cilët do të përfshiheshin në procesin e Auditimit Social.

Pas konsultimeve me komunitetin, grupet e interesit dhe shoqërisë civile, D+ në konsultim me projektin DEMOS u rekomandoi mbi 20 qytetarëve që të bëhen pjesë e ekipit të Auditimit Social.

Pas shprehjes së interesimit, qytetarët u ftuan në programin e trajnimit njëditor, gjatë të cilit u aftësuan për të realizuar procesin e Auditimit Social. Në një trajnim tjetër njëditor gjatë procesit të Auditimit Social ekipi u trajnuar për leximin e dokumenteve.

Konform metodologjisë së zhvilluar nga DEMOS dhe përshtatur nga BIRN, grupi i qytetarëve nga Lipjani themeluan ekipin e “Auditimit Social”. Atyre iu caktuan detyrat për të analizuar dhe mbikëqyrur dy projekte, “Ndërtimi i sallës së sporteve në shkollën Ismail Luma” dhe “Ndërtimi i çerdhes në Ruc të Ri – Faza e dytë”. Vlera e dy projekteve është 496,184.60 euro.

Dy Ekipet kanë punuar të ndarë, në monitorimin e Projekteve. Por, pas përfundimit, kanë zhvilluar konsultime të përbashkëta, për të evidentuar

gjetjet e përbashkëta e gjetjet specifike - të dy Projekteve të audituara.

Kush e themelon ekipin e Auditimit Social?

Ekipet e Auditimit Social janë të pavarura nga institucionet dhe mund të themelohen nga përfaqësues të komunitetit por edhe nga grupe të tjera. Ekipet funksionojnë të pavarura nga qeverisja dhe nuk nevojitet miratim nga institucionet publike për themelimin e tyre.

GJETJET E PËRGJITHSHME NË TË DY PROJEKTET

- 🔍 Komuna e Lipjanit ka një angazhim serioz në konsultimin e komunitetit në procesin e hartimit të buxhetit.
- 🔍 Komuna mban takime dhe konsultime publike të rregullta me qytetarët.
- 🔍 Përfshirja e grave në procesin e hartimit të buxhetit të komunës vazhdon të mbetet e ulët.
- 🔍 Të dy projektet e audituara janë projekte me rëndësi të madhe për komunitetin e Lipjanit.
- 🔍 Komuna nuk ka organizuar takime të veçanta për prezantimin e projekteve me komunitetet.
- 🔍 Procesi i prokurimit publik është zhvilluar pa ankesa nga ana e operatorëve ekonomikë.
- 🔍 Komuna ka dhënë kontrata bazuar në kriterin e çmimit më të lirë të përgjegjshëm.
- 🔍 Komuna ka publikuar kontratat për të dy projektet në uebfaqe.
- 🔍 Komuna nuk i kishte publikuar në mënyrë proaktive dokumentet e tjera, si raportet e mbikëqyrjes apo faturat e pagesave nuk janë publike në faqen e komunës.
- 🔍 Në faqen e komunës nuk ishin publike as projektet ekzekutive të të dy projekteve.
- 🔍 Komuna kishte publikuar vendimet për caktimin e menaxherëve për dy projektet.



Çka duhet të dijë një ekip i Auditimit Social?

Ekipet e Auditimit Social nuk nevojitet të jenë skajshmërisht profesionale. Ekipet kanë nevojë për vullnet dhe guxim qytetar si dhe rekomandohet të kenë njohuritë bazike në:

- *Funksionimin e Komunës;*
- *Qasjen në dokumente publike;*
- *Procesin e konsultimit me publikun - sidomos, gjatë planifikimit të Buxhetit dhe investimeve në Komunë;*
- *Procesin e Prokurimit publik.*

GJETJET SPECIFIKE NË PROJEKTIN “Ndërtimi i sallës së sportive në shkollën Ismail Luma”

Projekti i ndërtimit është ndërprerë pasi Komuna e Lipjanit ka bërë shkëputjen e kontratës me operatorin ekonomik fitues.

Pas ndërprerjes së punimeve, nuk është siguruar hapësira e punishtes nga operatori ekonomik.

Projekti ka anashkaluar në tërësi standardet për qasjen e personave me aftësi të kufizuar.

Projekti nuk ka paraparë një lidhje fizike mes sallës dhe shkollës.

Projekti nuk ka paraparë ndërtimin e zhveshtores, dhomës së rekuizitave dhe sanitarisë së veçantë.

Sipas paramasës, kaldaja e shkollës nuk ka kapacitete të mjaftueshme për ngrohjen e sallës.

GJETJET SPECIFIKE NË PROJEKTIN “Ndërtimi i çerdhes në Rufc të Ri – faza II”

Objekti i ndërtuar dallon në lokacion nga projekti ideor.

Projekti ka pasur vonesa për shkak të dështimit në tenderim, duke bërë që dy fazat e tenderit të shkojnë në ritenderim.

Komuna e Lipjanit lidhi edhe dy kontrata për punë shtesë në dy fazat e tenderit.

Në oborrin e çerdhes nuk është vendosur ndarja fizike me objektin e shkollës fillore “Migjeni”.

Këndi i lojërave nuk është përfunduar dhe lodrat e vendosura janë të papërshtatshme për fëmijët e çerdhes.



Ekipi i Auditimit Social

Ekipe e Auditimit Social janë grupe të qytetarëve, të cilët mbledhen me qëllim që të angazhohen në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike. Grupet vullnetare analizojnë procese me qëllim të ofrimit të rekomandimeve dhe përfshirjes më të madhe të qytetarëve në vendimarrje.

AMBIENTI KU ZHVILLOHET PROCESI I AUDITIMIT SOCIAL

Komuna e Lipjanit është në mesin e komunave mesatare në Kosovë me 57,605 banorë sipas regjistrimit të vitit 2011¹, me një buxhet prej 19,779,849.00 euro². Buxhet i komunës për investime kapitale është i vogël dhe ndihma nga projekti i Grantit të Performancës është me ndikim të madh në komunitet.

Lipjani është në mesin e komunave që përfitoi fondet e Grantit të Performancës Komunale. Fondet u vendosën të investoheshin në projektin e ndërtimit të sallës së sporteve në shkollën "Ismail Luma" dhe ndërtimin e çerdhes në Rufc të Ri. Projekti për ndërtimin e sallës së sporteve në shkollën "Ismail Luma", ishte pjesë e një aktiviteti të prokurimit si Loti i parë, së bashku me ndërtimin e sallës së sporteve në fshatin Banullë, për të cilat ishin ndarë 540,000.00 euro.

Ndërtimi i një sallesportive për shkollën fillore "Ismail Luma" ishte një nevojë e madhe për nxënësit e kësaj shkolle. Kjo shkollë me një numër të lartë nxënësish përballet me mungesën e një hapësire të përshtatshme për aktivitetet sportive dhe edukimin fizik, elemente këto të domosdoshme për mirëqenien dhe rritjen e fëmijëve. Komuna e Lipjanit nënshkroi një marrëveshje për mbështetjen financiare të projektit edhe për ndërtimin e çerdhes në Rufc të Ri, projekt

i cili ndodhej në fazën e dytë me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Helvetas Swiss Intercooperation, përfaqësuar nga DEMOS, për këtë projekt në vlerë të përllogaritur 260,000.00 euro, ku:

- Shuma totale e ndarë nga buxheti i DEMOS për këtë projekt ishte 250,000.00 euro
- Shuma totale nga buxheti i Komunës së Lipjanit për këtë projekt ishte 10,000.00 euro,
- dhe çdo vlerë tjetër që kalonte këtë shumë të projektit, do të financohej nga buxheti i komunës.

Ndërtimi i çerdhes në fshatin Rufc i Ri ka një rëndësi të madhe për komunitetin dhe gjeneratat e reja, duke krijuar mundësi për edukim dhe kujdes të hershëm për fëmijët e këtij rajoni. Kjo çerdhe do të ofrojë një mjedis të sigurt dhe edukativ për fëmijët e Rufcit të Ri, por edhe të fshatrave përreth si Ribar, Hallaq dhe fshatrave tjera të Lipjanit. Çerdhja paraqet një investim të rëndësishëm në të ardhmen e komunitetit, duke i ndihmuar edhe familjet e zonës pasi ky ambient iu ofron kujdes për fëmijët e tyre gjatë ditës, gjë që lehtëson angazhimin e prindërve në punë apo aktivitet tjera.



1 Popullësia në rajone dhe qytete. Agjencia Statistike e Kosovës. <https://ask.rks-gov.net/PopulationStats/PopulationByRegion> (qasur për herë të fundit me 28.10. 2024).

2 Korniza afatmesme buxhetore e Komunës së Lipjanit 2023 – 2025. <https://tinyurl.com/yj4p6uy7> (qasur për herë të fundit me 28.10.2024)

KAPITULLI I - GJETJET E PËRBASHKËTA NË TË DY PROJEKTET


Gjatë procesit të Auditimit Social në Lipjan, ekipi trajtoi një varg të temave të cilat u zbuluan gjatë analizimit të dokumenteve dhe vizitave në terren. Ekipi konstatoi probleme në fazën e konsultimeve me qytetarë, në procesin e planifikimit, fazën e tenderimit dhe implementimit të kontratave.

Gjetjet në procesin e konsultimeve me qytetarët

Qytetarët kanë një rol të rëndësishëm në procesin e planifikimit të buxhetit dhe zhvillimit të komunës. Ky bashkëpunim realizohet përmes takimeve dhe konsultimeve publike midis komunës dhe qytetarëve. Për të analizuar nivelin e përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrjen komunale, ekipi i Auditimit Social ka shqyrtuar dokumentacionin e krijuar gjatë takimeve dhe konsultimeve në Komunën e Lipjanit gjatë viteve të fundit.

Komuna e Lipjanit kishte publikuar në uebfaqe të komunës njoftimin³ për dëgjimet publike lidhur me Planifikimin e Buxhetit për vitet 2023 – 2025, ku ishin caktuar nëntë (9) takime, dy (2) në sallën e Kuvendit, ndërkohë shtatë (7) të tjera të organizuara në shkolla fillore dhe qendra rinore të fshatrave të qytetit. Në takimet publike për dëgjimet buxhetore me qytetarë dhe ekipe të tjera të interesit për Planifikimin e Buxhetit 2023 – 2025, ishin 142 pjesëmarrës, prej tyre vetëm 35 ishin gra (25%). Komuna organizoi takim të veçantë me gratë dhe shoqatat e gruas, organizatat e shoqërisë civile, shoqatat e të rinjve, klubet sportive, personat dhe shoqatat e personave me aftësi të kufizuar si dhe me fermerët e komunës. Procesverbali për dëgjimet publike për buxhetin 2023 – 2025 është i publikuar në uebfaqen e komunës, por i njëjti është shumë i përgjithësuar, duke mos specifikuar nevojat konkrete të qytetarëve të cilat janë ngritur në takime. Sipas këtij procesverbali, qytetarët në përgjithësi kanë dhënë mendimet e tyre për orientimin e buxhetit për investime, ku kanë dominuar propozimet për investime në infrastrukturë, në arsim dhe shëndetësi, por pa dhënë shumë detaje konkrete se për çfarë investime bëhet fjalë.

Ekipi i Auditimit Social ka analizuar edhe procesverbalet e publikuara nga Komuna e Lipjanit të dëgjimeve buxhetore për planifikimin e buxhetit për vitet 2024 – 2026.



Në bazë të procesverbaleve, del se komuna mbajti tetë (8) takime me qytetarë, të cilat u organizuan në sallën e Kuvendit Komunal. Takimet fillimisht u mbajtën me asamblistët e Kuvendit, pastaj me gratë dhe shoqatat e grave, organizatat e shoqërisë civile, personat me aftësi të kufizuar, klubet sportive, kryetarët e këshillave të fshatrave dhe banorët e fshatrave të Lipjanit.

Në këto takime morën pjesë 120 qytetarë, prej tyre 41 gra apo 34%. Megjithatë, ekipi i Auditimit Social vërejtë se përqindja e pjesëmarrjes së grave bëhej më e lartë për shkak të takimit të veçantë me gratë dhe shoqatat e grave, në të cilin morën pjesë 21 gra, ndërkohë në katër (4) takimet me banorët e fshatrave Sllovi, Grackë e Vjetër, Ribar i Madh dhe Baicë, morën pjesë vetëm dy (2) gra nga gjithsej 49 pjesëmarrës.


Ndërkohë, në bazë të analizimit të procesverbaleve të dëgjimeve buxhetore për KAB 2024 – 2026, ekipi i Auditimit Social evidentoi se ishin komuna kishte mbajtur gjashtë (6) takime, me gjithsej 105 pjesëmarrës, prej tyre 59 ishin gra (56%).

Në bazë të analizimit të raporteve të dëgjimeve buxhetore për planifikim të projekt-buxhetit për vitet 2023 – 2025 dhe 2024 – 2026, nuk është evidentuar se këto dy projekte janë paraqitur si kërkesa nga qytetarët pjesëmarrës në këto takime të organizuara nga Komuna e Lipjanit.


³ Komuna e Lipjanit. Njoftim për dëgjime publike. Gjetet në: <https://tinyurl.com/y3rhzk82> (qasur për herë të fundit me 28.10.2024).

Projektet nevojë e komunitetit

Dy projektet e financuara janë projekte të nevojshme për komunitetin e Lipjanit, ndonëse të njëjtat nuk është evidentuar se janë paraqitur si kërkesa në



dëgjimet buxhetore. Ndërtimi i një salle sporti për shkollën fillore "Ismail Luma" është një nevojë e madhe për nxënësit e kësaj shkolle. Kjo shkollë me një numër të lartë nxënësish përballet me mungesën e një hapësire të përshtatshme për aktivitetet sportive dhe edukimin fizik, elemente këto të domosdoshme për mirëqenien dhe rritjen e fëmijëve. Kërkesat për ndërtimin e sallës së sporteve datojnë që nga viti 2018, ku me fillimisht kryetari i Këshillit Drejtues të Shkollës i ishte drejtuar me kërkesë për ndërtimin e sallës së sporteve Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA)⁴, e pastaj edhe drejtori i shkollës kishte bërë kërkesë në drejtim të DKA-së për përfshirje të këtij projekti në planifikimin e investimeve kapitale për vitin 2019⁵. Ndërtimi i çerdhes në fshatin Rucf të Ri, po ashtu është i një rëndësie të madhe për komunitetin dhe gjeneratat e reja, duke krijuar mundësi për edukim dhe kujdes të hershëm për fëmijët e këtij rajoni. Kjo çerdhe do të ofrojë një mjedis të sigurt dhe edukativ për fëmijët e Rucfit të Ri, por edhe të fshatrave përreth si Ribar, Hallaq dhe fshatrave të tjera të Lipjanit. Çerdhja paraqet një investim të rëndësishëm në të ardhmen e komunitetit, duke i ndihmuar edhe familjet e zonës pasi ky ambient iu ofron kujdes për fëmijët e tyre gjatë ditës, gjë që lehtëson angazhimin e prindërve në punë apo aktivitetet e tjera.



Mungesa e diskutimit të projektit me komunitetin

Përpos dëgjimeve buxhetore, komunat në fazën e dizajnit të projekteve mund të zhvillojnë konsultime me komunitetin për të marrë nga ta sugjerimet për projektin përfundimtar.

Ekipi ka konstatuar se në fazën e planifikimit të projekteve, Komuna e Lipjanit ndonëse merr parasysh nevojat e qytetarëve për projekte kapitale, nuk organizon takime me qytetarët ku prezantohen këto projekte të detajuara investive, ku do të mund të merreshin komentet e qytetarëve të cilat pastaj do të mund të reflektoheshin në paramasë dhe paralogari. Diskutimi i projekteve me qytetarët përfitues të projekteve ndihmon në përmirësimin e cilësisë së projekteve dhe mundëson që qytetarët të ofrojnë komentet e tyre në fazën e hershme të planifikimit të investimeve.

Çka ndodh me rekomandimet?

Rekomandimet e grupeve të Auditimit Social shërbejnë për përmirësimin e qeverisjes. Rekomandimet do të përdoren për përmirësim të projekteve të ardhshme dhe për përmirësimin e projektit aktual.

4 Kërkesa nr. 182/2018 për ndërtimin e sallës së sporteve nga kryetari i Këshillit Drejtues, z.Alban Arifi, e bërë me datën:17.05.2018.

5 Kërkesa nr.186/2018 për ndërtimin e sallës së sporteve nga drejtori i ShFMU z.Driton Sadiku, e bërë me datën:23.05.2018.


Mungesa e transparencës në publikimin e projekteve investive dhe dokumenteve përcjellëse

Ekipi ka konstatuar se Komuna e Lipjanit ka publikuar kontratat e projekteve në faqen zyrtare të Komunës. Ekipi ka konstatuar se në faqen e komunës, kontratat u janë bashkuar edhe paramasat dhe parallogaritë me çmimet e kontraktuara.

Këtyre dokumenteve, komuna ua ka bashkëngjitur edhe vendimet për caktimin e menaxherëve të kontratave si dhe mbikëqyrësit të realizimit të kontratës, të cilët ishin pjesë e Drejtorisë së Infrastrukturës në komunë si dhe procesverbalin e hapjes së tenderëve, ku janë shënuar vlera totale e të gjitha kompanive që ofertuan në këtë tender. Këto dokumente komuna i ka bërë publike edhe në faqen e prokurimit elektronik, e-prokurimi.

Ekipi ka gjetur se projekti i detajuar nuk është publik në dy projektet investive. Bashkë me projektin mungojnë edhe dokumentet e prodhuara nga menaxheri i kontratës, faturat e pagesave dhe dëshmitë për ndryshimet në projekte.

Ekipi po ashtu konstatoi se Komuna e Lipjanit, konkretisht menaxherët e kontratave, nuk kishin publikuar në mënyrë proaktive dokumentet e tjera, si raportet e mbikëqyrjes apo faturat e pagesave, të cilat duhet të ngarkohen në faqen e e-prokurimit, por këto u siguruan përmes kërkesës për qasje në dokumente publike.



Kush e financon Auditimin Social?

Puna në ekipet e Auditimit Social është punë vullnetare. Të gjitha kostot që ndërlidhen me Auditimin Social mbulohehen përmes marrëveshjes së bashkëfinancimit në mes të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe projektit DEMOS. Investimet publike që monitorohen nga qytetarët përmes Auditimit Social edhe gjatë këtij viti kanë qenë investime që janë financuar nga Granti i Performancës Komunale.

KAPITULLI II - GJETJET SPECIFIKE NË PROJEKTIN “RREGULLIMI I SALLËS SË SPORTIT NË SHKOLLËN ISMAIL LUMA”

Në projektin e “Ndërtimit të sallës së sportit në shkollën Ismail Luma”, ekipi i Auditimit Social ka konstatuar probleme specifike të cilat lidhen me këtë projekt. Ekipi i Auditimit Social ka gjetur se punimet për ndërtimin e sallës kanë nisur me datën 17 korrik 2023, ku dhe është bërë hapja e punishtes.

Punimet kanë hasur në probleme për shkak të pengesave të një shtylle elektrike, e cila ishte në pjesën ku do të ndërtohej salla dhe Kompania Kosovare për Distribucion me Energji Elektrike në Kosovë (KEDS) ishte vonuar në dhënien e pëlqimit dhe zgjidhjes teknike të zhvendosjes.

Pas fillimit të punimeve për ndërtimin e sallës së sporteve, rrethojat mbrojtëse u vendosën vetëm pasi drejtori i shkollës këmbënguli për sigurinë e nxënësve dhe stafit. Mungesa e këtyre masave që në fillim të projektit përbënte një rrezik për të gjithë ata që frekuentonin shkollën, duke qenë se hapësira e ndërtimit mbetej e hapur dhe e pakontrolluar. Kërkesa e drejtorit për vendosjen e rrethojave siguroi që zona e ndërtimit të izolohej nga pjesa tjetër e shkollës, duke parandaluar aksidentet e mundshme dhe

duke siguruar një mjedis më të sigurt për fëmijët.

Në bazë të analizimit të raporteve të menaxherit të kontratës, vizita e fundit në terren ishte bërë më 20 nëntor 2023, ku ishte konstatuar se ishin kryer punimet të kontraktuara në vlerë 79,304.02 euro, për të cilat ishte bërë pagesa. Vlera e pagesës së realizuar ishte 52,295.07 euro nga Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal (MAPL), dhe 12,352.45 euro nga Komuna e Lipjanit.

Për shkak se punimet nuk kishin përfunduar brenda vitit, Komuna e Lipjanit humbi mjetet e MAPL-së për këtë projekt, mjete këto të cilat i takonin nga Granti i Performancës Komunale e të cilat mund të përdreshin vetëm gjatë vitit 2023.

Vonesat dhe shkëputja e kontratës

Sipas kushteve të veçanta të kontratës, përfundimi i të gjitha punëve ishte 120 ditë pas hyrjes në fuqi të kontratës, por jo më larg se 20 nëntori 2023. Pra, sipas kontratës të nënshkruar me operatorin ekonomik, projekti duhej të përfundohej brenda vitit 2023, por kjo gjë nuk ndodhi pasi punimet u ndërpre në pjesën e dytë të vitit 2023. Në vendimin për shkëputje të kontratës, komuna shkroi se mbajti disa herë takime me operatorin ekonomik në

mënyrë që të vazhdonin punimet, por duke mos pasur sukses bëri shkëputjen e njëanshme të kontratës më 31 maj të vitit 2024. Në bazë të analizimit të vendimit, të cilin ekipi i Auditimit Social e siguroi përmes kërkesës për qasje në dokumente zyrtare, thuhej se kontraktuesi nuk i ishte përmbajtur kontratës për largimin e shtyllës së betonit të rrjetit elektrik, e cila kishte qenë pjesë e paramasës së kontratës (pozicioni 13.5 të kapitulli Punët e Ndryshme).

“Furnizimi me material si dhe montimi i 2 shtyllave elektrike të betonit me lartësi 9m sipas standardeve për këtë veprimtari, në çmim të kalkulohet dislokimi i rrjetit ekzistues, furnizimi me kablo të nevojshme për funksionalizim të plot të rrjetit (Gjerësia mes dy shtyllave mesatarisht , deri 80m) , hapja e vrimës, vendosja e shtyllës, unazat e betonit, zhavorri si dhe betonimi i pjesës së unazave”.

Diskutimet për zgjatje të planit dinamik

Në takimin e organizuar me menaxherin e kontratës, ekipi i Auditimit Social u njoftua se Komuna dhe ekipi i operatorëve ekonomikë kishin pasur disa takime për zgjatjen e planit dinamik, por që ekipi i operatorëve ekonomikë nuk kishte pranuar, duke e dërguar lëndën në gjykatën kompetente. Sipas njoftimit për anulim të kontratës, ndonëse largimi i shtyllës ishte obligim kontraktual i operatorit ekonomik,

Komuna e Lipjanit kishte paraqitur një kërkesë në drejtim të KEDS për dislokimin e shtyllës në fjalë, ku kishte pasur vonesa. Duke marrë parasysh këtë vonesë nga KEDS, komuna kishte pranuar që të zgjaste planin dinamik. Operatori ekonomik ndërkohë pretendon se vonesat nuk kanë ardhur për fajin e tij, dhe se tejkalimi i planit dinamik të kontratës është përgjegjësi e Komunës dhe KEDS-it.



Rreziku në ndërtimin e papërfunduar

Pas shkëputjes së kontratës, objekti i sallës së sporteve ka mbetur në gjendje të papërfunduar, me ndërtimin e lënë përgjysmë, duke përfshirë vetëm bazamentin prej betoni dhe muret e ndërtuara me blloka. Brenda dhe përreth objektit mbeten të ekspozuara disa armatura të rrezikshme që nuk janë larguar, duke krijuar një ambient të pasigurt për nxënësit dhe për komunitetin e shkollës, pasi objekti ndodhet shumë afër shkollës. Mungesa e rrethimit të

punishtes, që është ende e hapur dhe e arritshme për fëmijët, e shton rrezikun e aksidenteve, duke e bërë të domosdoshme që të merren masa sigurie për të parandaluar qasjen e fëmijëve në këtë zonë të rrezikshme.

Struktura e objektit është në gjendje të mirë përkundër ndërprerjes së punimeve, megjithatë ekziston rreziku i dëmtimit nga reshjet gjatë stinës së vjeshtës dhe dimrit.



Gabimet në planifikimin e projektit

Ekipi i Auditimit Social ka analizuar dokumentacionet të cilat janë ofruar nga Komuna e Lipjanit në lidhje me projektin dhe specifikat teknike të tij, duke përfshirë dukjen e projektit, materialet dhe funksionalitetin e tij. Gjatë analizimit të këtyre materialeve, ekipi ka konstatuar disa probleme të cilat e kanë shoqëruar këtë projekt.

Fillimisht është konstatuar se Komuna e Lipjanit nuk ka kapacitete për të hartuar projekte dhe për këtë arsye kontraktin kompani të jashtme të cilat projektojnë për Komunën e Lipjanit. Gjatë diskutimit me përfaqësuesit e shkollës është konstatuar se gjatë projektimit ka disa defekte të cilat e pengojnë funksionimin normal të sallës.

Distanca fizike mes sallës dhe shkollës


Një nga defektet kryesore të evidentuara nga ekipi i Auditimit Social në projektim është se objekti i sallës së sporteve nuk është i lidhur fizikisht me ndërtesën e shkollës, konkretisht me korridorin e saj. Kjo do të thotë që nxënësit duhet të dalin jashtë ndërtesës për të hyrë në sallën e sporteve dhe po ashtu të kthehen në shkollë pas përfundimit të aktivitetit fizik. Një

situatë e tillë, veçanërisht gjatë stinës së dimrit, paraqet rrezik për shëndetin e nxënësve, të cilët, pas ushtrimeve ose lojës, mund të ekspozohen ndaj të ftohtit dhe lagështirës. Ndërkohë, ky problem mund të ishte zgjidhur fare lehtë përmes një korridori lidhës, pasi distanca ndërmjet ndërtesave është shumë e afërt dhe lehtë e realizueshme.

Mungesa e zhveshtores

Mungesa e zhveshtores në projektin për sallën e sporteve paraqet një problem të madh për nxënësit, të cilët nuk do të kenë një vend të përshtatshëm për ndërrimin e rrobave sportive. Pa një zhveshtore, nxënësit nuk do të kenë mundësi të ndërrojnë veshjet në mënyrë të rehatshme dhe të sigurt, duke krijuar probleme për zhvillimin e aktiviteteve sportive. Për më tepër, mungesa e hapësirës për ruajtjen e

rrobave dhe mbathjeve të tyre shkakton jo vetëm siklet, por edhe papastërti, pasi do të duhet t'i mbajnë me vete ose t'i vendosin diku ku mund të ndoten. Ky aspekt bëhet akoma më shqetësues kur nxënësit dalin jashtë në kushte të lagështa, duke rrezikuar që mbathjet dhe rrobat e tyre të përlyhen dhe të bëhen të papërshtatshme për t'u veshur më pas.



Institucioni	Komuna e Lipjanit	Projekti	Modeli	Parafjalje	Baza e Perzhvete	2
Titulli	Modeli	Titulli	Titulli	Titulli	Titulli	Titulli
Titulli	Titulli	Titulli	Titulli	Titulli	Titulli	Titulli
Titulli	Titulli	Titulli	Titulli	Titulli	Titulli	Titulli

Mungesa e dhomës së rekuizitave

Mungesa e një dhome ose hapësire të posaçme për rekuizitat sportive në sallën e sporteve paraqet një problem të rëndësishëm për arsimtarët e edukatës fizike. Pa një hapësirë të përshtatshme për vendosjen dhe organizimin e pajisjeve sportive, si topat e basketbollit, futbollit dhe volejbollit, konet për ushtrime, peshat, litarët për kërcime dhe dyshekët për ushtrime, arsimtarët e edukatës fizike do të përballen me vështirësi në mbajtjen dhe ruajtjen e këtyre materialeve në mënyrë të sigurt dhe të rregullt. Mungesa e kësaj dhome ndikon në efikasitetin e mësimdhënies dhe përdorimit të pajisjeve, pasi materialet e shpërndara pa rend në hapësira të tjera të sallës krijojnë një ambient të pakontrolluar dhe të pasigurt për nxënësit.

Mungesa e sanitarisë së veçantë

Mungesa e sanitarisë së veçantë për sallën e sporteve, përkatësisht tualetit dhe lavamanit për ujë, është një tjetër mangësi e projektit e evidentuar nga ekipi i Auditimit Social. Megjithëse, salla e sporteve është pjesë e shkollës, ajo është e ndarë fizikisht nga ndërtesa kryesore, duke i detyruar nxënësit dhe arsimtarët të dalin jashtë për të shkuar në tualet ose për të përdorur burimet e tjera sanitare. Kjo situatë paraqet vështirësi, veçanërisht në periudha me mot të ftohtë ose me shi, kur nxënësit, të djersitur dhe të lodhur nga aktivitetet, duhet të dalin jashtë për nevoja bazike higjienike. Për më tepër, mungesa e një lavamani për të pirë ujë brenda hapësirës së sallës e bën të vështirë për nxënësit të hidratohen gjatë ose pas aktivitetit fizik, duke ndikuar negativisht në komoditetin dhe shëndetin e tyre.

Problemi i kapacitetit të ngrohjes

Ekipi i Auditimit Social konstatoi po ashtu se sipas paramasës së projektit, ngrohja e sallës do të bëhej me pompën e ngrohjes e cila supozohej të kyçej në kaldanë ekzistuese të shkollës. Në diskutime me drejtorin e shkollës, i cili ishte pjesë e ekipit të Auditimit Social, u konstatua se kapaciteti i kaladasë së shkollës nuk është i mjaftueshëm për ngrohjen e sallës, ndaj për ngrohje adekuate të objektit kërkohet rritja e kapaciteteve të kadalsë ose sigurimi i ngrohjes alternative.

Mundësia që të luhen sporte të ndryshme në sallë

Një anë pozitive e projektit të sallës së sporteve që u evidentua nga ekipi i Auditimit Social, është që ky projekt ofron mundësi për zhvillimin e sporteve të ndryshme, duke mos u kufizuar vetëm në futboll, që shpesh luhet më shumë nga djemtë, por përfshinë edhe aktivitete të tjera që promovojnë barazinë gjinore. Në projekt ishte paraparë hapësira edhe për basketboll, volejboll, pingpong dhe gjimnastikë, pasi salla krijon një ambient gjithëpërfshirës ku vajzat dhe djemtë mund të angazhohen në mënyrë të barabartë në sporte të përshtatshme për të gjithë.

Mosplanifikimi i qasjes për personat me aftësi të kufizuar

Gjatë procesit të Auditimit Social, ekipi ka gjetur se projekti ka anashkaluar në tërësi standardet për qasjen e personave me aftësi të kufizuar. Hyrja e sallës në bazë të projektit është e paraparë me shkallë, dhe nuk ka pjerrtësi që sigurojnë qasjen e personave me aftësi të kufizuara.

KAPITULLI III - GJETJET SPECIFIKE NË PROJEKTIN “NDËRTIMI I ÇERDHES NË RUFC TË RI”

Grupi i Auditimit Social analizoi projektin për ndërtimin e çerdhes, duke vlerësuar të gjitha aspektet e tij estetike dhe funksionale. Gjatë këtij shqyrtimi, ata vunë re se projekti kishte një koncept bashkëkohor, me elemente moderne që reflektonin përkushtimin ndaj një ambienti të këndshëm dhe stimulues për fëmijët. Dizajni i zgjedhur ishte tërheqës dhe në përputhje me standardet e sotme, por krijonte gjithashtu një atmosferë të ngrohtë dhe mikpritëse. Për më tepër, grupi vlerësoi se ky projekt ishte shumë funksional, duke përfshirë hapësira të përshtatura për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme brenda objektit.

Çerdhja ka katër (4) klasë të barabarta, të pajisura me nyje sanitare, hapësira të fjetjes dhe qëndrimit, hapësirë e pritjes për prindërit, kuzhina, pjesën administrative dhe depo. Në total, kjo çerdhe ka kapacitet të akomodojë 80 fëmijë të kësaj zone.

Ndryshimi i pozitës nga projekti ideor

Në projektin ideor të dorëzuar nga kompania “Arhiko Ing”, objekti parashihej të ndërtohej në oborin e shkollës fillore “Migjeni”, konkretisht në pjesën veriore të oborrit me qasje në parcelë nga rruga lokale “Ismet Asllani”. Nga vizita në terren është parë që komuna ka ndryshuar pozitën nga projekti ideor, me çerdhen e cila është ndërtuar në pjesën perëndimore të oborrit, paralel me rrugën “Ismet Asllani”. Kjo zhvendosje ka bërë që çerdhja të këtë përballë shkollën, dhe të dy objektet shfrytëzojnë hyrjen e njëjtë, por që ende nuk ka një rrethim të hapësirës së çerdhes nga ajo e shkollës.



Kontratat për punë shtesë

Ekipi i Auditimit Social gjeti se Komuna e Lipjanit kishte dhënë edhe dy kontrata të tjera gjatë ndërtimit të çerdhes, që kanë rritur koston dhe kohën e përfundimit të projektit. Në fazën e parë, Komuna e Lipjanit kishte dhënë një kontratë për punë shtesë për blerjen, transportin, prerjen dhe vendosjen e armaturës ÇBR – 400 500 MPA, në tërësi në të gjitha pozicionet në vlerë 12 mijë e 595 euro.

Nevoja për aneks-kontratë ishte shfaqur edhe në fazën e dytë të ndërtimit të çerdhes, pasi sasia e kontraktuar për fasadë të tipit “Alucobond” nuk kishte qenë e mjaftueshme. Kjo kontratë ishte nënshkruar me kompaninë e njëjtë në nëntor të vitit 2023 për 23 mijë e 437 euro.

Ekipi i Auditimit Social ka gjetur se punimet për ndërtimin e çerdhes në Rufci të Ri kishin nisur me datën 16 shtator 2023, teksa përfundimi i çerdhes është bërë më 29 maj të vitit 2024. Për ta bërë çerdhen funksionale, ekipi i Auditimit Social gjeti se Komuna e Lipjanit kishte dhënë edhe dy kontrata të tjera, fillimisht në shkurt të vitit 2024 për furnizim të çerdhes me materiale të imta, shtrojë e mbulojë, si jorganë gjumi, mbulesa, jastëk, etj, në vlerë 9 mijë e 495 euro, dhe pastaj në mars, për furnizim me inventar dhe pajisje të ndryshme në vlerë 15 mijë e 275 euro.

Mungesa e rrethojave të oborrit të çerdhes

Gjatë vizitës në objektin e çerdhes, ekipi i Auditimit Social gjeti se çerdhja ka filluar punën me fëmijë, por janë disa probleme që duhet të adresohen nga Komuna e Lipjanit. Pasi çerdhja ndodhet në oborrin e shkollës fillore “Migjeni”, mungesa e një ndarje fizike të oborrit të shkollës me atë të çerdhes paraqet një sfidë për sigurinë dhe funksionalitetin e plotë të hapësirës. Kjo situatë krijon probleme të dukshme, veçanërisht në pjesën e fushës së sportit të shkollës, ku gjatë lojërave, topat godasin dritaret e çerdhes, duke rrezikuar sigurinë e fëmijëve të çerdhes dhe duke dëmtuar strukturën e objektit.



Çerdhja ofron qasje të lehtë për fëmijët dhe personat me nevoja të kufizuara pasi është në nivelin e tokës, megjithatë, qasja për personat



e verbër në oborr dhe hyrje nuk është e rregulluar, dhe banjot brenda çerdhes nuk janë të përshtatshme për personat në karroca.

Një tjetër çështje e pazgjidhur e evidentuar nga grupi i Auditimit Social ishte hapësira e hapur, pa rrethoja në oborrin e çerdhes që përshkruhet nga rruga lokale “Ismet Asllani”. Hapësira e hapur, shumë afër këndit të lojërave, përbente një rrezik të drejtpërdrejtë për fëmijët të cilët kanë filluar qëndrimin në çerdhe në shtator, pra para përfundimit të të gjitha punimeve në këtë hapësirë. Megjithatë, rrethimi i oborrit kishte filluar të vendoset dhe do të përfundonte me mbylljen e punimeve në hapësirën e parkut, gjë e cila u konfirmua nga Komuna e Lipjanit.

Këndi i lojërave i papërshtatshëm për fëmijët e çerdhes

Mungesa e një hapësire të jashtme të dedikuar vetëm për fëmijët e çerdhës, është një problem i dukshëm për edukatorët dhe vetë fëmijët, të cilët pothuajse gjithë aktivitetin e zhvillojnë brenda objektit të çerdhes. Gjatë vizitave në terren, ekipi ka vërejtur se komuna është duke përfunduar ndërtimin e një këndi lojërash, por ky projekt ende nuk

ka përfunduar dhe hapësira shfrytëzohej nga nxënësit e shkollës, dhe jo fëmijët e çerdhes. Komuna ka konfirmuar se këndi i lojërave do të pajiset me lodra të përshtatshme për fëmijët e çerdhes. Ekipi po ashtu ka vërejtur se hapësira përreth çerdhes dhe shkollës karakterizohet nga papastërtia, që ndikon në higjienën e mjedisit për fëmijët.

Intervenimet në hapësirat e brendshme të çerdhes

Hapësirat e brendshme të çerdhes plotësojnë standardet e nevojshme, duke ofruar mjaftueshëm hapësirë për fëmijët, shtretër për fjetje dhe një ambient të pastër e të mirëmbajtur. Megjithatë, çerdhja ka nevojë për furnizim për lodra didaktike si dhe me rafte të hapura për

lodra, të cilat duhet të vendosen në këndin e lojërave, gjë që do ta pasuronte përvojën edukative të fëmijëve. Ambientet e brendshme brenda çerdhes ofrojnë qasje për personat me aftësi të kufizuara.

PËRFUNDIME / REKOMANDIME

Ekipi i Auditimit Social në fund të projektit ka analizuar punën dhe ka arritur në disa përfundime.

Rekomandimet për përfshirjen qytetarëve:


Komuna të organizojë konsultime publike të hershme për të diskutuar për projektin që në fazën e ideimit ndihmon në identifikimin e nevojave specifike dhe shqetësimeve të komunitetit, duke shmangur problemet e mundshme që nga fillimi.

Në procesin e takimeve dhe konsultimeve me qytetarët, Komuna rekomandohet të avancojë mënyrën e organizimit të takimeve. Të fokusohet që në nisje të ofrohen më shumë informacione se çka ka ndodhur me projektet e kërkuara në të kaluarën.

Komuna duhet të ndërmarrë hapa për të përfshirë më shumë gra në dëgjimet buxhetore.

Për të realizuar një proces të mbikëqyrjes qytetare, komuna rekomandohet të rris transparencën ndaj qytetarëve përmes:

- Publikimit të më shumë dokumenteve rreth projekteve, duke përfshirë projektin dhe kontratën e plotë me operatorët ekonomikë.
- Publikimit të dokumenteve të tjera të prodhuara gjatë mbikëqyrjes së projekteve, si raportet e mbikëqyrësit apo raportet e pranimit teknik.
- Në tabelat e shpalljeve të vendosë emrin e mbikëqyrësit të kontratës apo adresën në të cilën qytetarët mund të dërgojnë informacione.
- Komuna rekomandohet që projektet madhore që prekin interesat e qytetarëve të nxirren në diskutime publike.



Rekomandimet për ndërtimin e sallës së sportit në shkollën “Ismail Luma”


Komuna të shpall tender të ri për rifillimin e punimeve në mënyrë që projekti të përfundohet sa më shpejtë.

Projekti i ri të përfshijë ndërtimin e një zhveshtoreje të përshtatshme ku nxënësit mund të ndërrojnë veshjet e tyre sportive në kushte komode.

Projekti i ri të përfshijë ndërtimin e një dhome për rekuizitat, ku arsimtarët mund të ruajnë pajisjet sportive si topat, konet, peshat dhe litarët, duke e bërë menaxhimin e pajisjeve më të sigurt dhe më efikas.

Projekti i ri të përfshijë ndërtimin e një lidhjeje fizike midis sallës dhe shkollës për të shmangur ekspozimin e nxënësve ndaj motit të ftohtë dhe për të garantuar qasje të sigurt gjatë dimrit.

Projekti i ri të përfshijë ndërtimin e një hapësire sanitare të veçantë me tualet dhe lavaman për ujë brenda sallës së sporteve.



Rekomandimet për ndërtimin e çerdhes në Rufc të Ri


Rrethimi dhe sigurimi i hapësirave të jashtme: Vendosija e një rrethimi për të ndarë oborrin e çerdhes nga ai i shkollës, si dhe sigurimi i një hapësire të dedikuar të lojërave për fëmijët e çerdhes.

Përmirësimi i këndit të lojërave: Pajisja e këndit të lojërave me lodra të përshtatshme për moshat e vogla, të cilat përmbushin standardet e sigurisë dhe zhvillimit.

Furnizimi me materiale didaktike: Sigurimi i mjeteve didaktike dhe rafteve të hapura në brendësi të çerdhes për t'i bërë lodrat dhe materialet e mësimit të qasshme për fëmijët.

Vendosija e sigurt e klimës dhe rregullimi i dritares: Rilokimi i klimës larg zonës së fjetjes dhe ngritja e dorezës së dritares për të parandaluar hapjen nga fëmijët.

Vendosija e shportave për mbeturina: Shtimi i shportave në zona të përshtatshme përreth çerdhes për të mbajtur ambientin të pastër dhe për të mësuar fëmijët për përgjegjësitë ndaj mjedisit.



Komisioni për pranimin teknik

Komisioni për pranimin teknik është një ekip profesional i komunës, i cili në fund të projektit inspekton punimet dhe në bazë të raportit të këtij ekipi, punët pranohen dhe kryhen pagesat.

Mbikëqyrësi i kontratës

Mbikëqyrësi i kontratës është një person apo kompani e angazhuar nga komuna. Ai është përgjegjës për të mbikëqyrur secilën fazë të implementimit të kontratës. Mbikëqyrësi harton raporte për secilën fazë.

METODOLOGJIA

Ky raport paraqet të dhëna të grumbulluara nga intervistat, kërkesat për qasje në dokumente publike, vizitat në terren dhe bisedat me zyrtarët komunalë, kompanitë implementuese dhe komunitetin. Në muajin korrik, DEMOS dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal duke u bazuar në standarde të paracaktuara përzgjedhi 20 projekte në 12 komuna të Kosovës, të cilat do të përfshiheshin në procesin e Auditimit Social.

DEMOS dhe MAPL në një proces të hapur përzgjedhën organizatat të cilat do të lehtësonin/fasilitonin procesin. BIRN dhe D+ pas vlerësimit nga juria profesionale u përzgjedhën të përfshiheshin në Auditimin Social të 11 projekteve në gjashtë komuna të vendit.

Emri i Projektit	Komuna	Vlera	Faza e Projektit në nisjen e Auditimit
Ndërtimi i shtratit të lumit Klina	Komuna e Klinës	746,046.00	Implementim
Ndërtimi i fundërruesit për filtrimin e ujit të pijes	Komuna e Klinës	849,921.63	Implementim
LOT 5 - Ndërtimi dhe rregullimi i shtigjeve në Parkun 'Karagaç'	Komuna e Pejës	234,500.00	Tenderim / Implementim
LOT 6 - Ndërtimi i Ambulantës në fshatin Trestenik	Komuna e Pejës	85,631.00	Tenderim / Implementim
Zgjerimi i rrugës 'Martirët e Kombit' - Hyrja Perëndimore e Qytetit	Komuna e Gjakovës	1,004,545.60	Implementim
Ndërtimi i hapësirave publike në qendër të qytetit	Komuna e Gjakovës	1,187,211.72	Implementim
Ndërtimi, trajtimi dhe pastrimi i shtratit të lumit me strukturën përcjellëse nga ura në qendër - deri te tranziti në Malishevë	Komuna e Malishevës	1,487,459.74	Para-tenderim
Ndërtimi i Çerdhes në Rufc të Ri - Faza II	Komuna e Lipjanit	247,958.69	Implementim
Llot 1 - Ndërtimi i Sallës së Sporteve, në shkollën 'Ismail Luma' në Lipjan	Komuna e Lipjanit	248,226.45	Implementim
Ndërtimi i Parkut dhe Fushës sportive në fshatin Bakshi	Komuna e Obiliqit	164,614.17	Implementim
Ndërtimi i Parkingut në Obiliq në objektet e banesave sociale 'Hade'	Komuna e Obiliqit	67,894.05	Implementim

Kush e themeloi grupin e Auditimit Social?

Grupi i Auditimit Social është një grup i qytetarëve të cilët në mënyrë vullnetare i përgjigjen nismës për t'u angazhuar në mbikëqyrjen e projekteve.

Me qëllim të përfshirjes sa më të gjerë të komunitetit, BIRN dhe D+ hartuan një listë me profesione dhe përfaqësues të komunitetit, të cilët do të ftoheshin për t'u bashkëngjitur në grup.


Në kriteret e përzgjedhjes u përcaktua se grupi synonte t'u jepte prioritet përfshirjes së kategorive të marginalizuara të shoqërisë siç janë gratë, të rinjtë, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe komunitetet jo-shumicë.

Baza e kriterëve të përzgjedhjes ishte metodologjia e DEMOS e cila sygjeron se cilat kategori të qytetarëve të cilët duhet të përfshihen në proces. Bazuar në këtë metodologji synohej që grupi të kishte laramani të profesioneve dhe moshave me qëllim të garantimit të gjithëpërfshirjes.

Ekipet e BIRN dhe D+ kontaktuan mbi 150 qytetarë nga 6 komunat për t'i ftuar ata që të bëhen pjesë e grupeve. Pas përgatitjes së listës preliminare BIRN ndau me DEMOS profilet e pjesëtarëve të rekomanduar dhe pas marrjes së komenteve, 120 qytetarë nga komunat e synuara u bënë pjesë e grupeve.

Në Lipjan u themeluan dy grupe, me 27 qytetarë, të cilët do të punonin në mbikëqyrjen e projekteve.

Përbërja e ekipit



Si u grumbulluan të dhënat?

Për përpilimin e këtij raporti ekipi i themeluar i Auditimit Social përdori disa teknika për të grumbulluar të dhënat.

Ekipi u angazhua për të kërkuar online të dhënat publike të komunës, ekipi hartoi një listë me pyetje për projektet dhe kërkoi informacione nga komuna, dërgoi kërkesa për qasje në dokumente publike dhe analizoi dokumentet e pranuar nga Komuna. Për të dokumentuar gjetjet, ekipi realizoi vizita në terren dhe zhvilloi takime me zyrtarët e Komunës së Lipjanit.

Të dhënat në raport janë grumbulluar nga 27 anëtarët e dy ekipet e Auditimit Social dhe raporti është hartuar me ndihmën dhe mbështetjen e ekipit të D+. Raporti është bërë publik pas adresimit të komenteve të pranuar nga Komuna e Lipjanit.

Validimi i të dhënave

Dy grupet e Auditimit Social në Lipjan punuan të ndara në identifikimin e problemeve në projektet e tyre dhe shkrimin e raporteve.

Në takimet e mbajtura grupet u dakorduan për gjetjet sistematike në dy projektet dhe për gjetjet specifike të projekteve individuale.

Ekipet u dakorduan edhe për rekomandimet e paraqitura në këtë raport. Pas strukturimit të gjetjeve ekipi është takuar me nënkryetarin e komunës dhe ka kërkuar komente nga komuna për gjetjet në raport. Para publikimit komuna ka pranuar raportin dhe përgjigjet e tyre janë të inkorporuara në këtë raport.

Pensionistë; Studentë; Ekonomistë; Profesorë; Handikos; Aktivistë; Banorë.

AKTIVITETET E GRUPIT TË AUDITIMIT SOCIAL

Korrik 2024	<ul style="list-style-type: none"> ● Vizita në terren ● Targetimi dhe identifikimi i profileve që do të jenë pjesë e ekipit ● Përgatitja e listës me profilet e anëtarëve të ekipit të Auditimit Social ● Zgjedhja e anëtarëve të ekipit të Auditimit Social
Gusht 2024	<ul style="list-style-type: none"> ● Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit me Komunën e Lipjanit ● Publikimi i materialeve promovuese në rrjetet sociale ● Trajnimi për Auditim Social ● Krijimi i grupit në platformën e komunikimit Viber ● Vizita e ekipit në terren ● Vizita në terren e ekipit të Auditimit Social për evidentim të gjetjeve ● Kontrollimi i materialeve të qasshme në platformat e hapura ● Caktimi i personave brenda ekipit për dërgimin e kërkesave në Komunë ● Dërgimi i kërkesave për qasje në dokumente publike ● Pranimi i përgjigjeve nga Komuna e Lipjanit
Shtator 2024	<ul style="list-style-type: none"> ● Trajnimi për leximin e dokumenteve ● Takimi me menaxherin e projekteve ● Komunikimi i ekipit me Komunën e Lipjanit ● Pranimi i përgjigjeve shtesë nga Komuna e Lipjanit ● Diskutimi dhe analizimi i dokumenteve të pranuar nga Komuna e Lipjanit ● Takimet periodike dhe vizitat në terren ● Analizimi i materialeve
Tetor 2024	<ul style="list-style-type: none"> ● Takimi i ekipit për analizimin e të gjitha dokumenteve të pranuar nga Komuna e Lipjanit ● Evidentimi i gjetjeve nga ekipi i Auditimit Social
Nëntor 2024	<ul style="list-style-type: none"> ● Ndarja e detyrave për ekipin në draftimin e raportit ● Vendosija e strukturës dhe përcaktimi i pikave të shkrimit të raportit ● Përcaktimi i detyrave për shkrimin e raportit ● Draftimi i rekomandimeve nga ekipi ● Draftimi i raportit mbi gjetjet dhe rekomandimet e ekipit të Auditimit Social ● Takimi me nënkryetarin e Lipjanit dhe përfaqësuesit e komunës ● Redaktimi i raportit ● Adresimi i komenteve dhe sugjerimeve ● Dërgimi i raportit për validim në komunë ● Prezantimi i raportit para zyrtarëve të komunës
Dhjetor 2024	<ul style="list-style-type: none"> ● Realizimi i fushatës mediale për promovimin e raportit ● Përpilimi i planeve të zbatimit të rekomandimeve të raporteve të Auditimit Social nga komunat

EKIPI I AUDITIMIT SOCIAL NË LIPJAN

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Profesioni / Funkzioni
1	Kamer Podrimqaku	Kryetar i Këshillit Lokal të Lagjes si dhe Arsimtar i lëndës Edukatë Fizike
2	Driton Sadiku	Drejtor i shkollës “Ismail Luma” Lipjan
3	Flakrim Zejnullahu	Profesor i Arkitekturës
4	Gazmend Osmani	Klubi i futbollit “Ulipana”
5	Xhylishahe Sadiku	Këshilli i prindërve të shkollës “Ismail Luma”
6	Florim Budakova	Arsimtar i lëndës “Edukatë fizike” dhe udhëheqës i shoqatës “Sporti shkollor” në shkollën “Ismail Luma”
7	Alush Bikliqi	Kryetar i Këshillit të Pacientëve në Lipjan
8	Afrim Mena	Handikos
9	Erdona Kadriolli	OJQ “Vizioni Rinor i Shalës”
10	Agim Ademi	Gazetar
11	Diart Salihu	Përfaqësues i të rinjve
12	Art Krasniqi	OJQ “YAHR”
13	Mimoza Zogaj	Këshilli i Prindërve të shkollës “Ismail Luma”
14	Ahmet Karameta	Pensionist
15	Melisa Sadiku	Këshilli i nxënësve të shkollës “Ismail luma”
16	Ganimete Osmani	Edukatore
17	Majlinda Krasniqi	Mësuese
18	Besmire Aliu	OJQ “In Time”
19	Besarta Troli	Psikologe
20	Leotrim Pajaziti	OJQ Vizioni Rinor i Shalës
21	Besim Zeneli	Handikos
22	Bleriana Kadriolli	Studente

23	Vlora Aliu	Mësimdhënëse
24	Erdona Kadriolli	OJQ Vizioni Rinor i Shalës
25	Muhamet Guci	Qytetar
26	Besart Arifi	OJQ VoREA
27	Agim Tasholli	Pensionist



Roli i moderatorëve në diskutimet publike

Roli i moderatorëve në diskutimet publike duhet të jetë më proaktiv. Moderatorët duhet të nxisin përfshirjen e qytetarëve në diskutime, për Projektet Komunale dhe për Buxhetin. Ata duhet të provokojnë debat dhe të nxjerrin ide e propozime, nga qytetarët pjesëmarrës.

Kush janë anëtarët e Ekipeve të Auditimit Social?

Anëtarët e Ekipeve të Auditimit Social janë pjesëtarë të komunitetit, të cilët nuk janë në konflikt të interesit me Projektin. Në Ekipe, nuk mund të jenë zyrtarët e institucionit - të lidhur direkt me Projektin dhe me procesin e mbikëqyrjes zyrtare të Projektit.

LETRA E KRYETARIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Me kënaqësi të madhe pranoj të ndaj me ju këtë raport të Auditimit Social, një dokument që pasqyron punën e grupeve të auditimit dhe përkushtimin tonë për transparencë, llogaridhënie dhe qeverisje të hapur. Ky proces ka shërbyer si një mundësi e jashtëzakonshme për të analizuar punën tonë, për të identifikuar pikat e forta dhe për të adresuar fushat ku ka ende hapësirë për përmirësim.

Dua të theksoj se për herë të tretë Komuna e Lipjanit në bashkëpunim me programin DEMOS, ka realizuar Auditimin Social. Ky bashkëpunim ka qenë dhe mbetet një shtyllë e rëndësishme për të forcuar qeverisjen lokale dhe për të siguruar që zëri i qytetarëve të jetë gjithnjë i përfaqësuar në punën tonë. Ne jemi të gatshëm që edhe në të ardhmen të vazhdojmë këtë partneritet të suksesshëm, duke e shndërruar atë në një model për zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.

Angazhimi ynë për të ofruar shërbime cilësore, për të investuar në projekte me ndikim afatgjatë dhe për të promovuar zhvillimin e barabartë mbetet në qendër të çdo vendimi që marrim si institucion. Ky Auditim Social ka luajtur një rol të rëndësishëm në evidentimin e rezultateve të punës sonë dhe në mbështetjen për përmirësimin e vazhdueshëm të administrimit tonë.

Në përfundim, dua të shpreh mirënjohjen time për ekipin që ka realizuar këtë Auditim Social dhe për mbështetjen e vazhdueshme të programit DEMOS dhe organizatën D+, ndihma juaj ka qenë e shumë e rëndësishme në krijimin e një baze të fortë për transparencë dhe përmirësim të shërbimeve publike. Komuna e Lipjanit do të vazhdojë të jetë një partner i besueshëm dhe i përkushtuar në përmbushjen e nevojave dhe pritjeve të qytetarëve të saj.

Me respekt,

Imri Ahmeti

Kryetar i Komunës së Lipjanit




LETRA E EKIPIT TË AUDITIMIT SOCIAL NË KOMUNËN E LIPJANIT

Procesi i Auditimi Social për ne si qytetarë ka qenë një qasje e re, të cilën nuk e kemi praktikuar më parë. Nga trajnimi që kemi ndjekur si dhe hapat të cilët i kemi ndërmarrë së bashku me organizatën Demokraci Plus, kemi marrë njohuri shumë relevante rreth këtij procesi. Po ashtu edhe një përvojë të jashtëzakonshme për përfshirjen tonë qytetare në monitorim të projekteve që komuna realizon për ne si qytetarë. Ajo çfarë na bën përshtypje është fakti i angazhimit tonë si qytetarë duke përfshirë profile/profesionet e ndryshme të qytetarëve, me qëllim që të kontribuohet në të gjitha dimensionet e mundshme. Mandej është metodologjia që nxitë qytetarët të jenë aktivë në monitorim dhe njëkohësisht në bashkëpunim të plotë me autoritetet komunale për të dhënë kontributin e përbashkët në këtë drejtim.

Nga i gjithë ky proces ne kemi arritur të eidentojmë çështjet për të cilat ne si qytetarë mendojmë se mund të bëhen më mirë dhe të jenë më shumë në funksionalizim të projekteve të monitoruara dhe të gjitha janë adresuar tek autoritetet komunale. Me këtë kemi arritur që sado pak të ndikojmë në rritjen e qytetarisë aktive në shoqëri dhe në rritjen e transparencës komunale për këto dy projekte.

Ne si grup i Auditimit Social e vlerësojmë lartë këtë qasje apo metodologji të monitorimit të projekteve kapitale, për faktin se rritë angazhimin qytetar, si Këshillat lokale, shoqërisë civile dhe të gjitha grupeve të mundshme të shoqërisë.

Ne urojmë që kjo qasje të arrihet të bëhet praktikë e punës, së pari e Këshillave Lokale dhe të mbështetet edhe nga shoqëria civile me qëllim të rritjes së transparencës dhe qytetarisë aktive në shoqëri.



Çka ndikon Auditimi Social?

Auditimi Social në Komunën e Lipjanit ndikoi në përmirësimin e mbikëqyrjes së projekteve.



Co-funded by
the European Union



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Sweden
Sverige